



ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Janar 2026

DOGANA SHQIPTARE NË FORUMIN ME BIZNESIN FRANCEZ



U zhvillua në Tiranë takimi ndërmjet **Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Francë-Shqipëri (CCIFA)** dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me qëllim forcimin e dialogut institucional dhe thellimin e bashkëpunimit mes Administratës Doganore dhe komunitetit të biznesit.

Drejtori i Përgjithshëm, **z. Genti Gazheli** në fjalën e tij theksoi se ky është takimi i parë zyrtar me CCIFA, i cili pritet të pasohet nga të tjerë, duke shprehur bindjen se ky bashkëpunim do të kontribuojë në forcimin e mëtejshëm të partneritetit Doganë-Biznes. Ai solli në vëmendje eksperiencat pozitive të mëparshme me operatorë të veçantë ekonomikë franceze, përfshirë dhënien e statusit Operator Ekonomik i Autorizuar subjektit **MARLOTEX**, në prani të përfaqësuesve të lartë të institucioneve shqiptare dhe franceze, si një shembull konkret i bashkëpunimit të suksesshëm dhe ftoi bizneset e pranishme të aplikojnë pranë Administratës Doganore për të përfituar nga lehtësitë që ofron ky status.

Z. Julien Roche, President i CCIFA, vlerësoi transparencën dhe profesionalizimin e Administratës Doganore si dhe rëndësinë e këtij komunikimi të drejtpërdrejtë dhe rolin e CCIFA në përfaqësimin e interesave të anëtarëve të saj. Gjithashtu, në këtë takim u theksuan marrëdhëniet historikisht shumë të mira mes Doganave Shqiptare dhe atyre Franceze, bashkëpunimi i vazhdueshëm me Atasheun Doganor Francez dhe Ambasadën Franceze në Tiranë.

MINISTRI I FINANCEVE DHE DREJTORI I DOGANAVE NË DY KOMPANI "AEO"

Ministri i Financave, **z. Petrit Malaj**, së bashku me drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, **z. Genti Gazheli**, zhvilluan një vizitë pune në dy kompani shqiptare, të cilat kanë përfituar statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar, kompaninë **"Everest"** dhe **"Albelettrica"**.

Administratori i kompanisë **"Everest"** vlerësoi përfitimet që statusi OEA i ka sjellë biznesit, duke theksuar thjeshtimin e procedurave doganore, reduktimin e kontrolleve, përshpejtimin e transportit dhe kursimin e kohës, element kyç për rritjen e eficiencës dhe konkurrueshmërisë. Edhe përfaqësuesit e kompanisë **"Albelettrica"** theksuan se certifikimi OEA ka sjellë lehtësira të ndjeshme në procedurat doganore, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e kostove dhe përmirësimin e performancës operacionale.



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave theksoi se përfitimet përfshijnë, ndër të tjera, më pak kontrolle dokumentare dhe fizike, zhdoganim lokal në ambientet e subjektit dhe kursim të ndjeshëm të kohës dhe kostove. Ndërsa ministri i Financave iu bëri thirrje të gjithë bizneseve që të aplikojnë për të përfituar këtë status.

Operatori Ekonomik i Autorizuar (OEA) është një status që u jepet operatorëve ekonomikë të besueshëm, të cilët përfitojnë nga thjeshtime dhe lehtësira doganore, si dhe nga një trajtim më i favorshëm nga administrata doganore. Deri më tani, këtë status e kanë përfituar 18 kompani, të cilat operojnë në sektorë të ndryshëm në treg.

TAKIM I NIVELIT TË LARTË PËR MODERNIZIMIN E SISTEMEVE DOGANORE

U zhvillua në Bruksel takimi i nivelit të lartë ndërmjet Administratës Doganore Shqiptare, **DG TAXUD** dhe **UNCTAD**, i fokusuar në modernizimin dhe përafrimin e sistemeve të informacionit doganor të Shqipërisë me standardet e Bashkimit Europian për periudhën 2025-2030.

Gjatë takimit u prezantua vizioni strategjik i modernizimit, si edhe teknologjitë më të reja ASYCUDA, përfshirë ASYCUDA Cloud Framework dhe zgjidhjet për rritjen e ndërveprimit, sigurisë dhe eficiencës së proceseve doganore.

Ky bashkëpunim përbën një hap të rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve institucionale dhe integritetit europian të sistemit doganor shqiptar.



TAKIME ME PUNONJËSIT E DEGËVE TIRANË, RINAS DHE DURRËS

Në kuadër të forcimit të dialogut të brendshëm institucional dhe përgatitjes së Administratës Doganore Shqiptare për procesin e integritetit europian, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, **z. Genti Gazheli**, zhvilloi disa takime pune me punonjësit e Degës Doganore Tiranë, Degës Doganore Rinas dhe Degës Doganore Durrës.

Gjatë këtyre takimeve, Drejtori i Përgjithshëm u ndal në rëndësinë historike që shënoi viti 2025 për Shqipërinë dhe veçanërisht për Administratën Doganore, me hapjen e negociatave për Kapitullin 29 – Bashkimi Doganor, si dhe Degës Doganore Rinas dhe kapitujt e tjerë ku përfshihet ADSH.

Ai theksoi se doganat luajnë një rol të veçantë në mbrojtjen e interesave fiskale dhe ekonomike, garantimin e sigurisë, si dhe lehtësimin e lëvizjes së mallrave dhe pasagjerëve, duke pasur parasysh se territori i Republikës së Shqipërisë do të përbëjë Bashkimit Europian.

"Ne, si pjesë e Doganave Shqiptare, kemi një rol kyç dhe një përgjegjësi të drejtpërdrejtë në procesin e aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Kontributi ynë është thelbësor për realizimin e këtij objekti kombëtar", u shpreh **z. Gazheli** gjatë fjalës së tij.



DOGANA SHQIPTARE VLERËSOHET ME ÇMIMIN E PARË NGA SELEC PËR 2025

Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (**SELEC**) ka vlerësuar Administratën Doganore Shqiptare me çmimin e vendit të parë për këtë vit, duke theksuar bashkëpunimin e suksesshëm ndërkufitar dhe shkëmbimin efektiv të informacionit mes autoriteteve doganore të vendeve anëtare.

Ky çmim pasqyron angazhimin dhe profesionalizimin e Doganave Shqiptare në luftën kundër krimit të organizuar, si dhe kontributin e tyre në menaxhimin e hetimeve të përbashkëta në rajon.

Hetimi i përbashkët Shqipëri-Turqi, i shpallur fitues, u fokusua në goditjen e trafikut të prekursorëve të drogës, duke rezultuar në sekuestrimin e një sasive të konsiderueshme barnash që përmbanin pseudofedrinë, të fshehura në bagazhet e disa pasagjerëve.



DOGANAT FORCOJNË BASHKËPUNIMIN NDËRKUFITAR PËR BIOSIGURINË

Në Degën Doganore Tushemisht, Vizita u organizua në bashkëpunim me **EU CBRN CoE** – Projekti P100 dhe logjistike koordinuese në kuadër të përgatitjes së ushtrimit ndërkufitar në terren P100 Institutit të Shëndetit Publik, Shqipëri-Maqedoni e Veriut, me qëllim forcimin e masave të biosigurisë dhe biosigurimit në vijën e parë.

Vizita u organizua në bashkëpunim me **EU CBRN CoE** – Projekti P100 dhe logjistike koordinuese në kuadër të përgatitjes së ushtrimit ndërkufitar në terren P100 Institutit të Shëndetit Publik, Shqipëri-Maqedoni e Veriut, me qëllim forcimin e masave të biosigurisë dhe biosigurimit në vijën e parë.

Gjatë aktivitetit, pjesëmarrësit shkëmbyen informacion dhe u koordinuan mbi përgatitjet për ushtrimin e planifikuar, duke u fokusuar në organizimin e përgjithshëm, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe rolet e strukturave të përfshira gjatë ushtrimit. Vizita në terren shërbeu për njohjen praktike me ambientet e PKK Tushemisht dhe për identifikimin e nevojave kryesore organizative.

